EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6739
E hënë, 24 tetor 2022
çmimi 0.40

## Kamberi u kërkon shqiptarëve të Luginës të regjistrohen: Jemi në fazën finale

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

# JOSEPH: ARRITJA E PESË NJOHJEVE NGA BE-ja E PËRFUNDON LOJËN E VUÇIQIT

FAQE 4-5



Profesori Edward P. Joseph nga Universiteti "Johns Hopkins" në Uashington ka thënë se pesë shtetet mosnjohëse të BE-së deri më tani i kanë dhënë një avantazh apo fuqi të padrejtë Serbisë për ta bllokuar Kosovën në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve

## PRESIDENTI I MALTËS: E MBËSHTESIM LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR KOSOVËN, JANË PËRMBUSHUR KRITERET





## BAJRAMI: MËSIMI DËSHTOI QË DY TË SHTUNA, TË SHKARKOHET ARBËRIE NAGAVCI

FAQE 6

## AKTUALE




### KURTI: NUK TOLEROJMË PREKJEN E SOVRANITETIT DHE INTEGRITETIT TERRITORIAL TË KOSOVËS F. 5

### FSK-ja E GATSHME TË OFROJË TRAJNIME PËR USHTRINË MAQEDONASE F. 6

### DAÇIQI, MINISTËR I JASHTËM NË QEVERINË E RE SERBE F. 2

## EKONOMI



### HOTI: MOSVEPRIMI I QEVERISË KA NXJERRË NGA QARKULLIMI EKONOMIK RRETH 500 MILIONË EURO F. 8

### MUNGESA E PUNËTORËVE, KOSOVA PO MERR PUNËTORË NGA TURQIA DHE INDIA F. 8

## SPORT



### DITË E BARAZIMEVE, KAMPIONI NDALET NË KLINË F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

## Daçiqi, ministër i Jashtëm në qeverinë e re serbe



**Beograd, 23 tetor** - Partia Përparimtare Serbe dhe Partia Socialiste e Serbisë kanë bërë publikuar emrat e ministrave të Qeverisë së re të Serbisë që do të udhëhiqet nga Ana Bërnabiq.
Lideri i socialistëve, Ivica Daçiq, do të jetë minister i Punëve të Jashtme, kryetar i Byrosë së Koordinimit të Shërbimeve të Sigurisë dhe zëvendëskryeministër i parë. Ai rikthehet pas dy vjetësh në krye të diplomacisë serbe.
Branislav Shashiq, ish-drejtori i Agjencisë së Sigurisë së Informacionit (BIA), do të jetë ministri i ri i Punëve të Brendshme të Serbisë. Millosh Vuçeviq, ish-kryetar i Novi Sadit dhe anëtar i lartë i Partisë Përparimtare Serbe, do ta marrë drejtimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe do të ketë edhe pozitën e zëvendëskryeministrit.
Sinisha Malli do të vazhdojë ta udhëheqë Ministrinë e Financave dhe do të jetë edhe zëvendëskryeministër, ndërkaq Maja Popoviq do të vazhdojë të jetë ministre e Drejtësisë.
Ndryshime ka në udhëheqjen e disa dikastereve të tjera, përfshirë Ministrinë e Integrimit Evropian, atë të Infrastrukturës, të Energjisë dhe të Tregtisë.
Qeveria e re serbe, po ashtu, do të ketë edhe ministra pa portofol, por edhe dy ministra nga radhët e minoriteteve. Husein Memiq do të jetë ministër i Turizmit dhe Rinisë. Memiq ishte bartës i listës së Partisë Demokratike të Sanxhakut.
Ndërkaq Tomisllav Zhigmanov, kryetar i Unionit Demokratik të Kroatëve në Vojvodinë, do ta udhëheqë Ministrinë për të Drejtat e Minoriteteve dhe Dialogut Social.
Partia Përparimtare dhe ajo Socialiste kanë numrat e nevojshëm në Parlament për ta formuar qeverinë. Parlamenti pritet ta zgjedhë qeverinë e re javën e ardhshme.
Qeveria e re serbe do të ketë 25 ministri, apo katër më shumë sesa ekzekutivi paraprak.
Serbia mbajti zgjedhjet parlamentare më 3 prill. Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve u shpallën më 5 korrik për shkak se në disa qendra të votimit në jug të Serbisë u përsëritën zgjedhjet.

# Sulmet masive ruse lënë miliona ukrainas pa rrymë


© AP/picture alliance

**Ukrainë, 23 tetor** - Rusia ka nisur sulme të reja ajrore "në shkallë të gjerë" ndaj ndërtesave të energjisë së Ukrainës, duke shkaktuar ndërprerje të rrymës në mbarë vendin, tha presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky.
Autoritetet ukrainase thanë se pothuajse 1.5 milion amvisëri në mbarë vendin kanë mbetur pa energji elektrike. Por, Zelensky tha se shumica e raketave dhe dronëve të Rusisë po rrëzohen, duke ripërsëritur një deklaratë të ushtrisë ukrainase që thoshte se 18 nga 33 raketat e lëshuara nga ajri dhe deti janë rrëzuar më 22 tetor. "Sigurisht ne ende nuk kemi aftësi teknike për t'i parandaluar 100 për qind të gjitha sulmet ruse me raketa dhe dronë. Jam i sigurt që gradualisht ne do të arrijmë ta bëjmë këtë me ndihmën e partnerëve tanë", tha Zelensky.
Gjatë dy javëve të fundit Rusia ka shtuar sulmet ndaj stacioneve të energjisë së Ukrainës, sistemeve të furnizimeve me ujë dhe infrastrukturë tjetër kyçe.
Sulmet e fundit kanë pasur për cak qytet perëndimore të Hmelnitskit dhe Lutskut, por edhe qytetin Uman në Ukrainën qendrore.
Hmelnitskit, shtëpi e 275 000 banorëve para se të niste lufta, ka mbetur pa energji elektrike, pasi mediet lokale raportuan për disa shpërthime.
Uman, po ashtu, ka mbetur pa energji, ndërkaq Lutsku ka mbetur pjesërisht pa rrymë pasi disa sulme goditën stacione të energjisë.
Sulmet ajrore kanë shkaktuar ndërprerje të energjisë në Odesa në jug, në Dnipropetrovsk dhe Zaporizhja në juglindje të Ukrainës.
Kompania kombëtare e rrymës, Ukrenergo, u ka bërë thirrje ukrainasve që ta kursejnë rrymën.
Zelensky tha se autoritetet kanë arritur t'i rikthejnë furnizimet me rrymë në disa rajone. "Caku kryesor i terroristëve është energjia", tha ai.
Ndërkaq, në kryeqytetin ukrainas, Kiev, autoritetet kanë nisur reduktimet e energjisë për shkak të krizës së shkaktuar nga sulmet ruse.
Zyrtarët ukrainas thanë se të paktën 40 për qind e sistemit elektrik të vendit është dëmtuar rëndë qëkur Rusia ka shtuar sulmet ndaj infrastrukturës energjetike.
Që nga 10 tetori, sipas Zelenskyt, 30 për qind e stacioneve të energjisë së Ukrainës janë shkatërruar nga sulmet ruse.

## Xi Jinping fiton edhe një mandat, promovon aleatët në pozita udhëheqëse



**Pekin, 23 tetor** - Presidenti i Kinës, Xi Jinping, ka promovuar aleatët e tij më të ngushtë në trupin udhëheqës të Partisë Komuniste. Ai konsolidoi edhe më shumë pushtetin, pasi më 23 tetor mori mandatin e tretë presidencial.
Xi emëroi në Komitetin e Përhershëm të Byrosë Politike katër aleatë të tij, përfshirë edhe dy ish-sekretarët e tij - të cilët mbështesin vizionin e tij për kontroll më të fortë mbi shoqërinë dhe ekonominë. Shefi aktual i Partisë në Shangai, Li Qiang, pritet ta marrë pozitën e kryeministrit nga Li Keqiang, i cili do të pensionohet vitin e ardhshëm. Li Qiang shihet si person i afërt me Xi, pasi të dy kanë punuar së bashku në provincën Zhejiang në fillim të viteve 2000.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Presidenti i Maltës: Mbështesim liberalizimin e vizave për Kosovën, janë përmbushur kriteret

**Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 23 tetor** - Presidenti i Maltës, George Vella, ka thënë se vendi i tij e mbështet liberalizimin e vizave për Kosovën pasi, siç ka thënë ai, ajo i ka përmbushur kushtet para katër vjetësh.
Në vizitën e tij në Prishtinë, Vella ka ritheksuar mbështetjen e vazhdueshme të Maltës për Kosovën në anëtarësimin e saj në Bashkimin Evropian. "Tani do ta shfrytëzoj këtë mundësi për ta ritheksuar mbështetjen e vazhdueshme të Maltës për Kosovën për anëtarësimin në BE. E mirëpres raportin e Komisionit Evropian dhe e inkurajoj Kosovën që ta vazhdojë rrugëtimin e saj reformues në perspektivën evropiane. Malta e mbështet propozimin e Komisionit Evropian për liberalizim të vizave duke qenë se ka përmbushur të gjitha kriteret para disa vjetësh. Katër vjet ka vonesë për liberalizimin e vizave. Kosova ka bërë çdo gjë që është kërkuar për liberalizimin e vizave", ka thënë Vella në konferencën për medie në Prishtinë së bashku me presidenten Vjosa Osmani.
Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka falënderuar presidentin Vella për mbështetjen e vazhdueshme të vendit të tij dhënë Kosovës. "Kjo vizitë është edhe një herë dëshmi e marrëdhënieve të shkëlqyeshme dypalëshe mes shteteve tona. Ne jemi jashtëzakonisht mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme nga shteti i Maltës që nuk ka munguar asnjëherë në të gjitha fazat e shtetndërtimit të Kosovës", ka thënë Osmani.
Presidenti i Maltës është takuar edhe me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca.

## Osmani: As ShBA-ja, as BE-ja s'kanë kërkuar të heqim dorë nga njohja reciproke

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se kërkesa që njohja reciproke të jetë pjesë e një marrëveshjeje finale me Serbinë është domosdoshmëri dhe tërheqjen e kësaj kërkese Kosovës nuk ia kanë kërkuar as Shtetet e Bashkuara, as Bashkimi Evropian.
Gjatë një konference për medie në Prishtinë, pas takimit me homologun e saj nga Malta, George Vella, Osmani u pyet t'i komentonte deklaratat e të dërguarit të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, që Kosova të mbështesë një marrëveshje me Serbinë, që nuk përfshin njohjen reciproke.
Por, Osmani tha se bëhet fjalë për "marrëveshje specifike", që duket se është referencë një propozim i Francës dhe Gjermanisë për të cilin kanë raportuar mediet.
Siç kanë deklaruar zyrtarët në Serbi, ky propozim franko-gjerman, që thuhet se u është dorëzuar liderëve në Prishtinë dhe Beograd, parasheh që Serbia të mos e pengojë Kosovën në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, përfshirë edhe Kombet e Bashkuara, në këmbim të një anëtarësimi të shpejtë të Beogradit në bllokun evropian. "Janë tjetër gjë propozimet për marrëveshje specifike të cilat diskutohen në Bruksel. Siç e dini, ka qenë çështja e energjisë, akoma vazhdojnë diskutimet për fatin e të zhdukurve me dhunë apo edhe tema të tjera që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes. Dhe përpjekjet e partnerëve tanë që të gjitha këto çështje të shtyhen përpara në një mënyrë të intensifikuar. Megjithatë, nuk ka pasur kërkesë, qoftë nga ShBA-ja, qoftë nga partnerët e tjerë brenda BE-së, që Kosova të heqë dorë nga kërkesa për njohje reciproke, sepse të gjithë e kuptojnë që ajo është domosdoshmëri që e përmbyll një kapitull të dhimbshëm të asaj çfarë ka ngjarë në këto dekada në Ballkanin Perëndimor, që kanë qenë luftëra të tmerrshme të iniciuara dhe të kryera nga ana e regjimit gjenocidal të Serbisë", shtoi ajo.




# Kamberi u kërkon shqiptarëve të Luginës të regjistrohen: Jemi në fazën finale

**Prishtinë, 23 tetor** - Deputeti i vetëm shqiptar në Parlamentin e Serbisë, Shaip Kamberi, u ka kërkuar shqiptarëve të Luginës së Preshevës që të regjistrohen teksa procesi ka hyrë në dhjetëditëshin final. Ai ka shkruar në "Facebook" se deri më tani regjistruesit shqiptarë kanë kryer punën e tyre shumë mirë, ndërsa qytetarët iu janë përgjigjur masivisht procesit të regjistrimit. "Procesi i regjistrimit ka hyrë në dhjetëditëshin final. Deri më tani regjistruesit shqiptarë kanë kryer punën e tyre shumë mirë, ndërsa qytetarët i janë përgjigjur masivisht procesit të regjistrimit. Tani jemi në fazën finale, prandaj ka nevojë për energji shtesë e vazhdimësi të vullnetit për t'u regjistruar çdo qytetar. Inkurajoj regjistruesit të vazhdojnë me intensitetin e lartë të punës, ndërsa qytetarët të vazhdojnë të regjistrohen. Të gjithë, deri te qytetari i fundit shqiptar. Është shumë me rëndësi, prandaj ju ftoj ta vazhdojmë këtë intensitet e këtë punë të filluar mirë", ka shkruar Kamberi.






# Joseph: Arritja e pesë njohjeve nga BE-ja e përfundon lojën e Vuçiqit

Profesori Edward P. Joseph nga Universiteti "Johns Hopkins" në Uashington ka thënë se pesë shtetet mosnjohëse të BE-së deri më tani i kanë dhënë një avantazh apo fuqi të padrejtë Serbisë për ta bllokuar Kosovën në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve

Prishtinë, 23 tetor - Një ndryshim në "qasje dhe mendësi" për dialogun Kosovë - Serbi nga faktori ndërkombëtar mund të çojë në njohjen e Kosovës nga pesë vendet e BE-së që ende s'e njohin, thotë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", profesori Edward P. Joseph nga Universiteti "Johns Hopkins" në Uashington. Sipas tij, ka përpjekje serioze që Kosova ta sigurojë njohjen nga pesë shtetet e BE-së: Spanja, Rumania, Qiproja, Greqia dhe Sllovakia.

Ai thotë se një sinjal për këtë është edhe deklarata e të dërguarit amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhënë televizionit "Kanal 10" më 19 tetor, se "njohja nga pesë shtetet mosnjohëse të BE-së është më e rëndësishmja që Kosova mund të marrë nga cilido proces".

Në të njëjtën kohë, shton Joseph, "kemi raportime të pakonfimuara, por raportime se propozimi franko-gjerman vendos në qendër njohjen e Kosovës nga shtetet jonjohëse të BE-së".

Ky propozim, në të cilin thirret Joseph, qarkullon në mediet në Kosovë tash e një muaj dhe thuhet se ka për qëllim ta lehtësojë zgjidhjen e problemeve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Mes të tjerash, propozimi parasheh që Serbia të mos e pengojë anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, në këmbim të anëtarësimit më të shpejtë në BE.

Propozimi, sipas raportimeve, nuk përmend njohje reciproke midis Kosovës dhe Serbisë, por njohjen e Kosovës nga pesë shtetet mosnjohëse të BE-së.

Kosova ka shpallur pavarësinë në vitin 2008 dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka konstatuar se ajo nuk bie ndesh me ligjin ndërkombëtar.

Joseph thotë se pesë shtetet mosnjohëse të BE-së deri më tani i kanë dhënë një avantazh apo fuqi të padrejtë Serbisë për ta bllokuar Kosovën në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve. "Kur ia largon fuqinë Serbisë, krijon mundësinë për atë që të gjithë e duan. Një negociatë të drejtë [të balancuar]. Askush nuk dëshiron ta poshtërojë Serbinë, por qëllimi është një negociatë e drejtë", thotë Joseph për "Radion Evropa e Lirë".

Ai shton se këto njohje do ta përfundonin "lojën e Aleksandar Vuçiqit", president i Serbisë, i cili, siç thotë Joseph, pretendon se "dëshiron kompromis të drejtë me Kosovën" dhe se "është partner i Perëndimit". "[Kur të arrihet njohja nga pesë vendet e BE-së] njohja e Serbisë do të jetë e pashmangshme dhe më pak e rëndësishme", thotë Joseph.

Kosova dhe Serbia, me ndërmjetësimin e BE-së, kanë nisur dialogun për normalizimin e marrëdhënieve qysh në vitin 2011. Palët kanë arritur dhjetëra marrëveshje, por zbatimi i shumicës prej tyre ka ngecur.

Kosova insiston që marrëveshja përfundimtare me Serbinë ta ketë njohjen reciproke në qendër, por Serbia kundërshton.

Në javët e fundit në Kosovë dhe Serbi ka pasur vizita të shpeshta të përfaqësuesve të Bashkimit Evropian dhe të ShBA-së me qëllim të diskutimit për dialogun.

Kjo qasje e re në dialog, thotë ai, është propozuar edhe në një raport analitik të publikuar nga Instituti për Politika të Jashtme dhe Qendra Wilson në Uashington në janar të këtij viti. Në këtë raport, ku ka edhe autorë nga Ballkani, thuhet se "njohja e Republikës së Kosovës nga shtetet mosnjohëse do ta transformonte dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës të udhëhequr nga BE-ja". Sipas këtij raporti, një lëvizje e tillë do të ndikonte në stabilitetin e gjithë rajonit të Ballkanit.

Ky raport, po ashtu, përshkruan disa hapa se si një strategji e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara do të mund t'i siguronte njohjet e kërkuara, duke punuar së pari me Greqinë.

Joseph thotë se ka sinjale që kjo mendësi karshi dialogut Kosovë - Serbi vjen nga administrata e presidentit aktual të ShBA-së, Joe Biden. "Ky është një ndryshim shumë i madh në perceptim dhe pozicion nga Shtetet e Bashkuara dhe administrata Biden", thotë Joseph. Sipas tij, "është krejtësisht e mundur" që hapa konkretë drejt këtij plani të ndodhin në një të ardhme të afërt.

Joseph shton se ShBA-ja ka filluar ta ndërlidhë situatën mes Kosovës dhe Serbisë me "situatën e mjerë në Evropë", që ka shkaktuar pushtimi i Ukrainës nga Rusia. Ai përmend faktin se Serbia është ndër vendet e vetme në Evropë që nuk ka vendosur sanksione ndaj Rusisë. "Duhet të largohen iluzionet se [Aleksandar] Vuçiq është partner [i Perëndimit] apo se Serbia është në anën e duhur të historisë", thotë Joseph.

Dy nga çështjet bilaterale mes Kosovës dhe Serbisë dhe ndër më problematiket kanë të bëjnë me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe dhe me ndërrimin e targave ilegale të veturave në veri të Kosovës.

Formimi i një asociacioni prej dhjetë komunash me shumicë serbe në Kosovë është paraparë me një marrëveshje të arritur mes Kosovës dhe Serbisë në vitin 2013.

Në vitin 2015, ndërkaq, palët kanë arritur një marrëveshje mbi parimet për krijimin e këtij asociacioni. Por, ajo nuk është zbatuar asnjëherë pasi, sipas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ka pasur elemente që bien në kundërshtim me Kushtetutën.

# Kurti: Nuk tolerojmë prekjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës

PRISHTINË, 23 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se Kosova nuk do ta lejojë prekjen e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të saj. Gjatë një fjalimi në Këshillin e Përgjithshëm të partisë së tij, Lëvizjes Vetëvendosje, Kurti foli për luftën e paprovokuar të Rusisë ndaj Ukrainës, duke thënë se "ashtu siç veproi Serbia dje" me luftërat në Ballkanin Perëndimor, ashtu "po vepron Rusia sot". "Le ta dinë të gjithë, kur kërkojmë të respektohen pavarësia dhe integriteti territorial i Ukrainës, as që bëhet fjalë të mendohet se do ta tolerojmë prekjen e pavarësisë, sovranitetit apo integritetit territorial të Kosovës. Këto nuk janë të diskutueshme asnjëherë, askund për ne", tha kryeministri Kurti.

Ai porositi se bota po përballet me rikthimin e politikës fashiste, që tha se po sponsorizohet nga presidenti rus Vladimir Putin. "Pikërisht sot është rikthyer në rend të parë rëndësia e të qenit antifashist, kundër diskriminimeve me bazë gjinore, etnike, fetare, kundër çdolloj diskriminimi", theksoi Kurti.

Kurti tha se Serbia dhe Rusia kanë lidhje historike e kulturore "në linjat e autokracisë e të despotizmit, të agresionit dhe gjenocidit".

Serbia është shteti i vetëm në Ballkanin Perëndimor që nuk ka vendosur sanksione ndaj Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës. Megjithatë, Beogradi ka votuar disa rezoluta të Kombeve të Bashkuara që dënojnë Moskën për pushtimin e paprovokuar të Ukrainës.

Kosova u është bashkuar sanksioneve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara pas nisjes së pushtimit të Ukrainës më 24 shkurt. Po ashtu, institucionet u kanë ofruar strehim të përkohshëm disa gazetareve ukrainase.

Serbia ka lidhje të ngushta me Rusinë dhe llogaritë në Moskën kur bëhet fjalë në bllokimin e Kosovës për t'u anëtarësuar në organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Kosova dhe Serbia që nga viti 2011 zhvillojnë dialog që ka për qëllim normalizimin e plotë të raporteve. Prishtina kërkon që një marrëveshje përfundimtare ta përfshijë njohjen reciproke, por Serbia thotë se do një zgjidhje kompromisi, pa treguar se për çfarë kompromisi bëhet fjalë.




Që nga ajo kohë BE-ja ka përsëritur vazhdimisht qëndrimin se Kosova dhe Serbia duhet t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog, përfshirë edhe atë për Asociacionin. Kjo është kërkesë e vazhdueshme edhe e ShBA-së. Megjithatë, Qeveria e Kosovës është kundër një asociacioni njëetnik, ndërsa Serbia këmbëngul që ai të formohet dhe kërkon që të ketë kompetenca ekzekutive. Joseph mendon se fjala kyçe në këtë çështje është sekuenca (rendi i veprimeve) e jo përmbajtja (si duket Asociacioni).

Ai mendon se është obligim i Kosovës zbatimi i kësaj marrëveshjeje, por shton se "nuk mund të finalizohet statusi i serbëve të Kosovës pa pasur në të njëjtën kohë një finalizim të marrëdhënies mes Kosovës dhe Serbisë". "Në esencë, ekziston një pozicion i armiqësisë aktive nga Serbia për Kosovën. Nuk mund të kesh një fqinj armiqësor dhe në të njëjtën kohë të zgjidhet statusi i serbëve të Kosovës, që kontrollohen nga Serbia përmes Listës Serbe [subjektit më të madh politik të serbëve në Kosovë]", thotë Joseph.

Në veri të Kosovës, ndërkohë, serbët kanë edhe më pak se dhjetë ditë kohë për t'i riregjistruar makinat e tyre me targa që i lëshon Kosova.

Që nga paslufta, më 1999, ata vozitin makina me targa që i lëshon Serbia, e që nga Kosova konsiderohen të paligjshme.

Qeveria e Kosovës ka dhënë dy muaj kohë për riregjistrimin e makinave nga 1 shtatori deri më 31 tetor.

Meqë kjo çështje, më herët, ka qenë burim i tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe, Escobari tha se ka kërkuar shtyrjen e afatit të riregjistrimit për rreth dhjetë muaj.

Joseph mendon se kjo kërkesë, qoftë nga ShBA-ja apo BE-ja, është e padrejtë t'i bëhet Kosovës, pa e balancuar me një kërkesë për sundimin e ligjit në veri.

"Problemi është që po shpërblehen ata që krijojnë jostabilitet. Nuk mjafton që ShBA-ja dhe BE-ja vetëm t'i kërkojnë shtyrje Kosovës. Problemi nuk është [vetëm] të shmanget dhuna në veri, por sundimi i ligjit në Kosovë, përfshirë veriun, dhe adresimi i strukturave kriminale në veri", thotë Joseph.

Në veri të Kosovës me vite funksionojnë struktura paralele që financohen nga shteti serb. Rikujtojmë se në lidhje me kërkesën për shtyrje të riregjistrimit, Qeveria e Kosovës ka thënë se ka për obligim zbatimin e ligjit.

## Parandalohet edhe një rast i kontrabandës të mallrave

**Prishtinë, 23 tetor** - Zyrtarë policorë nga Stacioni Policor për Mbikëqyrjen e Kufirit Hani i Elezit, në zbatim të masave për parandalim dhe luftimin e kriminalitetit ndërkufitar, me theks të veçantë të kontrabandës, kanë shtuar patrullimet dhe operacionet policore në terren. "Kështu, më 22.10.2022, rreth orës 08:20, njësia policore patrulluese në fshatin Seqishtë-Hani i Elezit ka ndaluar një automjet me targa vendore - poste të shpejtë, të cilin e drejtonte i dyshuari mashkull kosovar, ku janë hasur mallra që dyshohet të jenë kontrabanduar", ka njoftuar Policia e Kosovës.
Sipas këtij njoftimi, gjatë kontrollit janë gjetur tekstil, këpucë, pajisje elektronike etj. "Me urdhër të prokurorit kujdestar iniciohet rasti 'kontrabandim me mallra', malli konfiskohet dhe i dorëzohet pikës doganore, ndërsa personi i dyshuar lirohet në procedurë të rregullt. Rasti është trajtuar nga njësitë përkatëse policore të Drejtorisë Rajonale Kufitare Lindje dhe Dogana e Kosovës", ka njoftuar Policia e Kosovës.



# Kosova ndan Medalje Presidenciale për gratë ukrainase



**Prishtinë, 23 tetor** - "Nëse dëshirojmë ta mirëmbajmë paqen, mund ta bëjmë vetëm nëse gratë janë në tavolinat vendimmarrëse", tha presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë punimeve të Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Në kuadër të këtij forumi gratë ukrainase u nderuan me Medalje Presidenciale.
Forumi, i njohur si WPS, po mbahet për herë të parë në Kosovë dhe organizimi i tij kishte qenë zotim i Kosovës në kuadër të Samitit për Demokraci që u mbajt në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 2021.
Në fjalimin hapës, Osmani u shpreh e pikëlluar për faktin se ish-sekretarja amerikane e Shtetit, Madeleine Albright, e cila vdiq në mars të këtij viti, nuk mund ta shohë organizimin e këtij forumi. "Znj. Albright ishte planifikuar të jetë folësja kryesore. Albright do të mbetet një figurë historike për këtë vend për kontributin që ka dhënë për sigurinë e paqen", tha Osmani.
Osmani tha se folësit e panelet e këtij forumi kanë për qëllim diskutimin mbi gratë dhe rolin e tyre në zona të konfliktit. "Kemi këtu përfaqësues të Ukrainës dhe gazetare nga Ukraina. Ajo që po e dëshmon vendi juaj na e kthen kujtesën tonë të luftës", tha Osmani duke përmendur pushtimin e paprovokuar rus të Ukrainës që nisi më 24 shkurt të këtij viti.
Ajo përmendi edhe kontributin e grave kosovare para, gjatë dhe pasluftës në Kosovë që u zhvillua në fund të viteve '90 si dhe rëndësinë e barazisë së grave në përparimin e shteteve. "Historia e Kosovës është historia e secilës grua që e ka hequr një gur nga rruga drejt barazisë", tha Osmani.
Në kuadër të Forumit, Osmani ndau Medalje Presidenciale për gratë në Ukrainë. "Kjo shkon për nënat, motrat, vajzat, luftëtaret, gazetaret, aktivistet. Ky çmim është simbol i përkrahjes së Kosovës pasi qëndrojmë së bashku që në të ardhmen të gëzojmë së bashku paqen", tha Osmani.
Këtë çmim e pranoi deputetja ukrainase Yevheniya Kravchuk së bashku me disa gazetare ukrainase që po qëndrojnë në Kosovë në kuadër të një projekti të Qeverisë së Kosovës për strehimin e gazetareve ukrainase. "Shumë gra të Ukrainës janë viktima të kësaj lufte, por janë, gjithashtu, edhe luftëtare, gazetare dhe do të ngadhënjejmë", tha Kravchuk.

# Bajrami: Mësimi dështoi që dy të shtuna, të shkarkohet Arbërie Nagavci

**Prishtinë, 23 tetor** - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, ka kërkuar nga kryeministri Albin Kurti që ta shkarkojë ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci. "Kryeministri Kurti duhet t'i kërkojë përgjegjësi Nagavcit për dështimin e zëvendësimit të mësimit, që dy të shtuna radhazi Arbërie Nagavci është përgjegjëse pse dështoi edhe këtë të shtunë zëvendësimi i orëve mësimore. Kryepërgjegjësi është Albin Kurti, i cili po e toleron një ministre të tallet me mijëra fëmijë e familje", ka shkruar Bajrami në "Facebook".
Ajo ka theksuar se kryeministri duhet t'i kërkojë ministres Nagavci që të arrijë sa më shpejt marrëveshje me prindërit për zëvendësimin e orëve të humbura shkaku i grevës. "Nëse dështon edhe të shtunën e ardhshme zëvendësimi i orëve mësimore, atëherë ministres së Arsimit duhet t'i kërkohet përgjegjësi dhe të shkarkohet menjëherë. Partia në pushteti erdhi në qeveri për t'i zgjidhur të gjitha 'çështjet kombëtare e ndërkombëtare', por po dështon në ekonomi, shëndetësi, diplomaci e më së shumti po dështon në arsim", ka thënë deputetja Bajrami.





## FSK-ja e gatshme të ofrojë trajnime për ushtrinë maqedonase

**Prishtinë, 23 tetor** - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur në takim homologen e tij nga Maqedonia Veriore, Slavjanka Petrovska, me të cilin ka diskutuar për bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve fqinje në trajnime, ushtrime të përbashkëta ndërmjet dy ushtrive.
Përmes një postimi në "Facebook", Mehaj ka theksuar se FSK-ja është e gatshme që ushtrisë maqedonase t'i ofrojë trajnime në fushën e kërkim-shpëtimit, ndërsa pala maqedonase do ta shkëmbejë përvojën e reformimit të brendshëm gjatë rrugëtimit në procesin për anëtarësim në Programin e Partneritetit për Paqe, ku edhe Kosova synon të jetë anëtare. "Po ashtu, një fushë tjetër në të cilën jemi pajtuar të bashkëpunojmë është integrimi i grave në ushtri, shkëmbimi i praktikave më të suksesshme, shkollimi i oficerëve dhe trajnimi i tyre është çështje për të cilën do të angazhohemi së bashku", ka shkruar Mehaj.

# Hoti: Mosveprimi i qeverisë ka nxjerrë nga qarkullimi ekonomik rreth 500 milionë euro

**Prishtinë, 23 tetor** - Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka bërë më dije se raporti i Komisionit Evropian për ekonominë e Kosovës për tremujorin e tretë 2022 thekson se: Rritja e Produktit të Brendshëm Bruto u ul në 2.1 për qind kryesisht për shkak të rënies së investimeve totale me 16.8 për qind; shpenzimet kapitale të qeverisë u zvogëluan me 30 për qind, që është shkaktari kryesor i ngadalësimit të rritjes ekonomike; deficiti tregtar i mallrave u thellua nga 51 për qind në 53 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto; të hyrat buxhetore u rritën për 15 për qind për shkak të inflacionit të lartë; si rezultat, suficiti i buxhetit të qeverisë arriti në 2.9 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto. "A ka qenë e mundur të evitohen disa nga këto probleme ekonomike? Apo së paku të zbuten? Sigurisht që po. Ja dy masa të thjeshta që kanë qenë plotësisht nën kontrollin e qeverisë: 1. Nëse do të mbaheshin shpenzimet kapitale të qeverisë së paku si në vitet e mëparshme, e jo të uleshin me 30 për qind apo me rreth 200 milionë euro, do të shtohej aktiviteti ekonomik, që do të rezultonte me normë më të lartë të rritjes ekonomike, më shumë vende pune, më shumë të ardhura për familjet dhe fitime për bizneset, si dhe më shumë tatime për shtetin. 2. Nëse qeveria do ta ulte TVSh-në dhe akcizën në disa mallra (në naftë në veçanti), atëherë sot do të kishim rreth 300 milionë euro më shumë në qarkullim në ekonomi, në llogaritë bankare të qytetarëve dhe bizneseve. Vetëm me këto dy masa të thjeshta do të qarkullonin në ekonomi edhe 500 milionë euro shtesë", ka deklaruar Hoti.
Ai ka theksuar se këto dy masa i kanë propozuar si opozitë. "Dhe të dy masat kanë qenë plotësisht nën kontrollin e qeverisë. Nëse do të ndërmerreshin me kohë, do të kishim një vit krejt tjetër në aspektin ekonomik dhe më lehtë do ta kishim përballuar krizën. Një qeveri e djathtë do të kishte vepruar kështu. Qeveria e djathtë arriti që në kulmin e pandemisë dhe izolimit ekonomik, gjatë periudhës qershor 2020 - mars 2021, të fuste në ekonomi direkt dhe indirekt rreth 700 milionë euro. Kjo u arrit pavarësisht se të hyrat në buxhet kishin rënë 600 milionë euro", ka thënë Hoti.




# Mungesa e punëtorëve, Kosova po merr punëtorë nga Turqia dhe India

**Prishtinë, 23 tetor** - Drejtori i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Berat Mustafa, ka thënë se për shkak të mungesës së punëtorëve, Kosova po merr punëtorë nga Turqia dhe nga India. Ai ka bërë me dije se këta punëtorë janë të specializuar dhe kryejnë shumë punë. "Ka që i kanë marrë nga Turqia, ka edhe shumë kërkesa nga India. Për shkak se ka shumë fuqi punëtore, por edhe janë shumë të trajnuar, të specializuar dhe kryejnë shumë punë", u shpreh Mustafa, duke shtuar se kjo nuk lë për të kuptuar se ka mungesë të punëtorëve në Kosovë por, sipas tij, nuk ka punëtorë të kualifikuar, duke theksuar se kompanive të mëdha iu kushton trajnimi i tyre.
Xhevat Muqa, ndërmarrësi që u kthye nga Zvicra në Kosovë, ka folur për tregun e punës dhe mungesën e fuqisë punëtore në vend. Ai për RTV21 u shpreh se e gjithë kjo është për shkak të mosliberalizimit të vizave. "Po të kishte qenë liberalizimi i vizave para një dekade kjo nuk kishte me ndodh sot, sepse të rinjtë e Kosovës kishin pas mundësi me shiju Evropën dhe me pa se çka është e vërteta. Gjithë qytetarët e Kosovës janë me një hamendje t'u jetu në Kosovë", është shprehur ai.
Ai ka theksuar se menjëherë pas luftës është kthyer në Kosovë, ku edhe ka hapur biznes.



Drejtori i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Berat Mustafa, ka thënë se çdo prodhues ka mungesë të fuqisë punëtore, duke theksuar se tani po ikin edhe punëtorët që kanë një vend pune e një pagë mesatare. Ai u shpreh se prodhuesit kanë një trend të rritjes së prodhimit dhe eksportit, por tani mungesa e fuqisë punëtore po vërehet në mënyrë drastike. "Çdo prodhues ka mungesë të fuqisë punëtore. Po çka është shqetësuese është se para disa vjetëve ne e kemi pasur problem që ka ikur një pjesë e njerëzve që kanë qenë të papunësuar, kurse tani kemi ikje të njerëzve të cilët kanë një vend pune dhe kanë një pagë solide", u shpreh Mustafa.
Ekonomisti Median Hashani u shpreh se ikja nga Kosova për një pagë më të mirë nuk është zgjidhje. Hashani u shpreh se "pas pagës 2 000 euro që marrin në Gjermani, në fund të muajit nuk iu mbetën më shumë se 500 euro dhe në Gjermani nuk mundesh me jetu me 500 euro".

## KEDS-i fillon pilotprojektin për inspektimin e rrjetit elektrik me dron

**Prishtinë, 23 tetor** - KEDS-i ka nisur monitorimin dhe inspektimin e rrjetit distributiv me dron. Fillimisht si pilotprojekt dronët u aktivizuan gjatë ditëve të fundit të shtatorit dhe në fillim të tetorit mbi linjat 10 kV Keqekollë dhe 10 kV Restelicë, që janë linja në terrene të vështira malore.
Në zona të tilla, për shkak të konfiguracionit të terrenit, ekipet e kanë të vështirë të depërtojnë për ta kryer punën e tyre, sidomos pas reshjeve atmosferike ose erërave të mëdha. Prandaj, një teknologji e tillë do të ndihmojë në uljen e rreziqeve për punëtorët e terrenit si dhe në shkurtimin e kohës së marrjes së të dhënave dhe intervenimit në sanimin e rrjetit apo prishjeve eventuale.



# LPK DHE TRI USHTRITË ÇLIRIMTARE



Ismet SYLEJMANI

Duhet të thuhet se as partitë politike shqiptare para luftës dhe as partitë politike shqiptare të dalura nga lufta e pas hyrjes së NATO-s në Kosovë, nuk janë themeluese të tri ushtrive çlirimtare, por zyrtarisht e historikisht vetëm Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK është themeluese jo vetëm e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por Ajo është themeluese edhe e Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, por është themeluese edhe e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare!

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, është themeluar nga Lëvizja Popullore e Kosovës!

Ushtria Çlirimtare për Preshevë Medvegjë dhe Bujanoc, është themeluar nga Lëvizja Popullore e Kosovës!

Ushtria Çlirimtare Kombëtare, është themeluar nga Lëvizja Popullore e Kosovës!

Themeluese direkte e tri ushtrive çlirimtare të popullit shqiptar në Kosovë, në Luginë të Preshevës dhe në Maqedoninë e Veriut, është pa as më të voglin dyshim, me fakte dhe me argumente të mjaftueshme të shkruara dhe të arkivuara e historike, askush tjetër, por vetëm Lëvizja Popullore e Kosovës!

Aktiviteti titanik e heroik i Heronjëve të Kombit Kadri Zeka, Jusuf Gërvalla, Rexhep Malaj, Nuhi Berisha, Zija Shemsiu, Afrim Zhitia, Fahri Faliu, Fadil Vataj, Hasan Ramadani, por edhe i shumë heronjëve e dëshmorëve të tjerë, të rënë në përpjekjet e mëdha për vetëdijësim, për liri, për çlirim e për pavarësi, u vazhdua me konsekuencë nga Lëvizja Popullore e Kosovës dhe nga veprimtarët e sajë të mëdhenjë e të devotshëm, e cila më 17 Nëntor të vitit 1994 themeloi UÇK-në, në vitin 2000 themeloi UÇPMB-në dhe në vitin 2001 themeloi UÇK-Kombëtare!

Të gjitha këto tri ushtri çlirirmtare bënë realitet pjesë të mëdha nga ëndrrat e Heronjëve dhe Dëshmorëve të Kombit të rënë në fushbeteja të ndryshme, për Atdheun e çliruar dhe jetën e lirë dhe të pavarur të popullit shqiptar në tokën e të parëve! Këto tri ushtri janë ato që shkruan faqe të tëra të lavdishme të historisë së popullit shqiptar nëpër trevat ku luftuan dhe bënë realitet ëndrra të mëdha Heronjësh dhe Dëshmorësh të Kombit tonë!

**Prishtinë, 21 Tetor 2022**






# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

## Loriana Kuka e fiton medaljen e bronztë në Abu Dhabi



Loriana Kuka ka arritur ta fitojë medaljen e bronztë në Grand Slamin e Abu Dhabit. Xhudistja nga Kosova ka arritur që pas një kohe të gjatë të fitojë medalje.
Kuka u eliminua në çerekfinale, por kishte rastin të luftonte për medaljen e bronztë nëpërmjet repesazhit. Në kategorinë deri në 78 kilogramë, Kuka arriti ta mposhtë francezen Audery Tcheumeo. Kjo ishte medalja e parë për Kukën që nga janari i vitit 2021.

# Ditë e barazimeve, kampioni ndalet në Klinë

Prishtinë, 23 tetor - Tri ndeshjet që u luajtën në kuadër të javës së 13 në AlbiMall Superligë nuk kanë sjellë fitues. Dy ballafaqime kanë përfunduar me shifrat 1:1, teksa në njërën përballje nuk ka pasur gola fare.
Skuadra kampione në fuqi, Ballkani, nuk ka arritur ta arkëtojë më shumë se 1 pikë në stadiumin "18 Qershori" në Klinë në përballje me Dukagjinin. Albion Rrahmani i kaloi kampionët në fuqi në epërsi në minutën e 62-të me golin e shënuar me gjuajtje me kokë pas harkimit të Armend Thaqit, por një pikë për skuadrën e Armend Dallkut e siguroi Altin Merlaku me golin e shënuar nga penalltia në minutën e 78.
Nga një gol secila skuadër shënoi edhe në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë, ku u ballafaquan Trepça '89 dhe Gjilani. Skuadra mitrovicase në fund u nda e kënaqur me epilogun e ndeshjes, duke pasur parasysh se që nga minuta e 9 luajti me një lojtar më pak, pas përjashtimit me karton të kuq të Lulzim Pecit për shkak të ndërhyrjes ndaj Përparim Islamit, i cili u detyrua të largohet nga fusha me autoambulancë. Baton Zabërgja e kaloi Gjilanin në epërsi në minutën e 41-të, derisa shifrat i barazoi Christian Mba në minutën e 50.
Me një lojtar më pak tërë pjesën e dytë e zhvilloi edhe Malisheva në duel me Drenicën në stadiumin "Bajram Aliu", por në fund arriti të marrë një pikë, pasi ndeshja u mbyll pa gola (0:0).



# Barcelona po shpreson të nënshkruajë me Asension

Marco Asensio vazhdon të mbetet një çështje brenda kampit të Real Madridit.
Sulmuesi spanjoll është futur në vitin e fundit të kontratës me Los Blancos dhe ende nuk e ka vazhduar bashkëpunimin.
Drejtuesit e kampionëve në fuqi të Evropës i kanë ofruar kontratë të re lojtarit, por ai deri më tani nuk e ka pranuar atë, pasi dëshiron t'i shikojë të gjitha opsionet.
Barcelona mbetet favorite kryesore për të nënshkruar me anësorin, pasi trajneri Xavi Hernandez e vlerëson shumë atë.
Sipas të përditshmes katalunase "Mundo Deportivo", besohet se trajneri Xavi ka biseduar me lojtarin dhe i ka premtuar se do të ketë hapësira të mëdha nëse vendos të transferohet në Camp Nou.
26-vjeçari këtë edicion ka zhvilluar vetëm 114 minuta në 10 ndeshje me Realin, por



ka arritur të shënojë dy gola, një në kampionat dhe një tjetër në Ligën e Kampionëve.
Gjithsesi, përveç Barcelonës, në garë për Asension mbeten edhe Juventusi, Milani dhe Manchester Unitedi.

# McGregor mbetet jashtë kafazit edhe për gjashtë muaj të tjerë shkaku i testimeve anti-drogë

Conor McGregor po përballet me të paktën gjashtë muaj të tjerë si i përjashtuar, pasi nuk është testuar për drogë për më shumë se një vit. Ish-kampioni i UFC-së në dy pesha nuk ka luftuar që kur theu këmbën në humbjen e dytë radhazi nga Dustin Poirier verën e kaluar. Irlandezi kishte shpresuar të luftonte këtë vit, por rikthimi i tij u shty më 2023 pasi pësoi një pengesë në rikuperimin e tij.



McGregor kishte marrë kohë për ta xhiruar filmin e tij të parë pasi mori pjesë në kastin e Road House së bashku me Jake Gyllenhall dhe më vonë u zbulua se ai nuk ishte testuar për drogë që nga tremujori i tretë i vitit të kaluar. Luftëtarët duhet të jenë në grupin e testimit për gjashtë muaj në mënyrë që të kenë të drejtë të luftojnë. Presidenti i UFC-së, Dana White, konfirmoi se do të jetë rasti me McGregor si sinjalizim ndaj luftëtarëve të tjerë.

## Unitedi ka parë mjaftueshëm nga Ronaldo: Djajtë e Kuq do ta lirojnë portugezin

Pasi u la jashtë skuadrës së Manchester Unitedit për ndeshjen e tyre kundër Chelseat, duket se Djajtë e Kuq po mendojnë ta largojnë Cristiano Ronaldon.
Sulmuesi portugez u ndëshkua nga trajneri Erik ten Hag pasi refuzoi të hynte në lojë gjatë fitores 2-0 të së mërkurës ndaj Tottenhamit, më pas shkoi në dhomën e zhveshjes dhe u largua nga stadiumi pa leje.
ESPN raporton se klubi ka parë mjaft nga Ronaldo, madje është i gatshëm ta lë atë të shkojë si lojtar i lirë.
Pengesa më e madhe është paga e sulmuesit, pasi ai paguhet afërsisht 500 mijë euro në javë.
Pak vite më parë Ronaldo konsiderohej futbollisti më i mirë në botë, por gjërat kanë ndryshuar pasi ai i afrohet moshës 38-vjeçare.
Kjo është arsyeja pse Unitedi është i gatshëm ta huazojë atë.
Duke pasur parasysh se kontrata e Ronaldos skadon verën e ardhshme, huazimi i tij do të nënkuptonte gjithsesi lirimin e tij falas pasi ai nuk pritet të nënshkruajë një rinovim kontrate.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

1Nr.464/01-57437
Datë: 21.10.2022

Në bazë të dispozitave të neneve 11, 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4, nenit 7 dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë:Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë:/Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.20/21 Qershor 2016 Prishtinë, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

## V E N D I M

**I.** MIRATOHET shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat ndikohen nga projekti për ndërtimin e segmentit rrugor "Bashkim Krasniqi" në Lipjan, sipas tabelave të përshkruara nga evidenca kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik, si dhe sipërfaqet e tyre të cilat tabela paraqesin pjesët përbërse të këtij vendimi.

**II.** Vlera e kompensimit të pronës caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 Tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativë Nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

**III.** Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Infrastruktur dhe Drejtorati i Shërbimeve Publike.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërën nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë..

I'u dërgohet:
-të gjitha Drejtorive
-Arkivit të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN REPUBLIKA KOSOVO LIPJAN

Page 1 of 3

Përshkrimi detaj i parcelave kadastrale sipas Certifikatës-Njësisë kadastrale për shpronësim për rrugën "Bashkim Krasniqi" në Lipjan

| K.K. Lipjan | | | | | K.K. Lipjan | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjendja e vjetër | | | | | Gjendja e re | | | | |
| Nr. | Pronar | Parcela kadastrale | Kultura-klasa | Sipërfaqe m² | Pronar | Parcela kadastrale | Kultura-klasa | Sipërfaqe e mbetur m² | Sipërfaqe për rrugë m² |
| 1. | Nebojsha Andrijevic (Dragisha) | P-71409044-01857-1 ZK LIpjan | Arë e kl.1 | 442 | Gjerëtanishmi | E re | | 282 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 160.4 |
| 2. | Lubisha Andrejeviq (S.) | P-71409044-01857-2 ZK LIpjan | Arë e kl.1 | 1684 | Gjerëtanishmi | E re | | 1502 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 182.24 |
| 3. | Novica Jorgiq (Stojadin) Milena Laziq (Stojadin) Zorica Daniqiq (Stojadin) | P-71409044-01879-1 ZK LIpjan | Arë e kl.1 | 1137 | Gjerëtanishmi | E re | | 1015 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 122.02 |
| 4. | Novica Jorgiq (Stojadin) Milena Laziq (Stojadin) Zorica Daniqiq (Stojadin) | P-71409044-01878-4 ZK LIpjan | Arë e kl.1 | 675 | Gjerëtanishmi | E re | | 553 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 122.02 |
| 5. | Miladin Jorgiq (Agapija) | P-71409044-01878-1 ZK LIpjan | Arë e kl.1 | 746 | Gjerëtanishmi | E re | | 629 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 117.48 |
| 6. | Miladin Jorgiq (Agapija) | P-71409044-01880-0 ZK LIpjan | Arë e kl.1 | 5271 | Gjerëtanishmi | E re | | 5176 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 94.93 |
| 7. | Zhivojina Jorgiq (Agapija) | P-71409044-01881-1 ZK LIpjan | Arë e kl.1 | 4420 | Gjerëtanishmi | E re | | 3954 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 466.42 |
| 8. | Blorim Fazliu (Xhezahir) | P-71409044-01167-6 ZK LIpjan | Arë e kl.1 | 1690 | Gjerëtanishmi | E re | | 1532 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 157.84 |
| 9. | Ninoslav Dejanoviq Nadica Mcgee (Novica) | P-71409044-01167-7 ZK LIpjan | Arë e kl.1 | 374 | Gjerëtanishmi | E re | | 0 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 374 |
| 10. | Ninoslav Dejanoviq Nadica Mcgee (Novica) | P-71409044-01167-8 ZK LIpjan | Arë e kl.1 | 97 | Gjerëtanishmi | E re | | 0 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 97 |
| 11. | Sadat Ejupi | P-71409044-01171-3 ZK LIpjan | Rrugë e pakategorizuar | 76 | Gjerëtanishmi | E re | | 0 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 76 |
| 12. | Milosh Laliq (S.) | P-71409044-01940-2 ZK LIpjan | Kullosë e kl.1 | 676 | Gjerëtanishmi | E re | | 672 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 3.77 |
| 13. | Miodrag Radiq ( Petra) | P-71409044-01941-1 ZK LIpjan | Kallamishte e Kl.1 | 312 | Gjerëtanishmi | E re | | 189 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 123.1 |
| 14. | Jelica Arsiq (UD.Ljubomira) | P-71409044-01942-1 ZK LIpjan | Kullosë e Kl.1 | 1230 | Gjerëtanishmi | E re | | 813 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 417.01 |
| 15. | Rexhep Tahiri (Sadik) | P-71409044-01944-7 ZK Lipjan | Livadh i Kl.1 | 376 | Gjerëtanishmi | E Re | | 335.22 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 40.78 |
| 16. | Basri Grajqevci (Hamit) | P-71409044-01944-8 ZK Lipjan | Livadh i Kl.1 | 250 | Gjerëtanishmi | E Re | | 195 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 55.05 |
| 17. | Gafurr Buja | P-71409044-01943-2 ZK Lipjan | Arë e Kl.1 | 943 | Gjerëtanishmi | E Re | | 282.18 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 660.82 |
| 18. | Gafurr Buja | P-71409044-01944-9 ZK Lipjan | Livadh i Kl.1 | 21 | Gjerëtanishmi | E Re | | 0 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë Lokale | | 21 |

Page 2 of 3

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

## NJOFTIM

Në mbështetje të paragrafit 7.3 të nenit 8 të Ligji Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës **01Nr.464/01-57437 datë 21.10.2022**, njoftohen të gjithë subjektet të përshkruar në Vendimin e bashkangjitur të këtij njoftimi se:

**1.** Për arritjen e qëllimit publik për realizimin e projektit për ndërtimin e segmentit rrugor "Bashkim Krasniqi" në Lipjan, mbas plotësimit të të gjitha kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28.10.2010, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullaret e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqet e tyre, e cila tabelë është pjesë përbërse e këtij vendimi.

**2.** Kryetari i Komunës do të marrë një Vendim Preliminar brenda periudhës prej 30-ditëve kalendarike pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28.10.2010, lidhur me organizimin e dëgjimeve publike.

**3.** Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar në Organin shpronësues, brenda 10 ditëve kalendarike, mbas shpalljes së Vendimit të Kryetarit të Komunës **01Nr.464/01-57437 datë 21.10.2022**, për miratimin e kërkesës për shpronësim ditën e publikimit në njërën nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.

**4.** Kryetari i Komunës do të mbaj një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e kërkuar për realizimin e projektit për ndërtimin e segmentit rrugor "Bashkim Krasniqi" në Lipjan,.

**5.** Të gjithë personat që janë zyrtar publik të Komunës në të cilën mbahet dëgjimi publik apo pronar ose zotrues të interesit në pronën e cila gjindet në këtë pjesë ose avokat apo përfaqsues i ligjshëm të këtyre përsonave, kanë të drejt të marrin pjesë në dëgjimin publik.

**6.** Çdo person i interesuar do t'i jepet mundësi e arsyshme për t'i shprehur mendimet e ti/saj gojarisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafët 2,3,4 të nenit 9 të Ligjit Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28.10.2010.

**7.** Çdo person i interesuar i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjell me vete prova të arsyshme (dokumente) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i intersit ose avokat ose përfaqsues i ligjshëm i atij zyrtari publik, Pronari ose Zotërues i Interesit.

**8.** Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave tjera në pronat e paluajtshme që ndodhen brenda juridiksionit territorial të komunës së Lipjanit, do të mbahet me **datë 02/11/2022 në ora 10⁰⁰, në objektin Komunës së Lipjanit- salla e Kuvendit**.

**9.** Në rast se prona është objekt i kërkesës shpronësohet pas përmbylljes së procedurës së shpronësimit të incuar në përputhje me at kërkesë asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmisimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose pemëve apo bimëve të mbjellura në pronë pas datës së përmbushjes së dispozitave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të Ligji Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/1-205 datë 28 tetor 2010. Çdo person i cili pretendon se ka një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në pronën përkatëse këshillohet ta shqyrtoj Ligjin Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/1-205 datë 28 Tetor 2010, dhe të kërkojë ndihmë profesionale juridike për kuptimin e drejtave të tyre sipas ligjit.

**10.** Çdo person i cili nuk është emruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në cilendo parcelë të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim menjëherë duhet të dërgojë në Organin shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj, bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikura të çfarëdo dokumenti që ndërlidhen në atë pretendim.

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN REPUBLIKA KOSOVO LIPJAN










## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arber Zeqiraj shpall të pavlefshme diplomën e Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Xheladin Deda" në Mitrovicë, në vitin 2018.

- Luljeta Shaqiri shpall të humbur diplomën e masterit, të lëshuar nga Kolegji UBT, drejtimi: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomiks.

- Gjon Paluca shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Rejall Shope shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

- Lorena Binaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Vëllezërit Frashri " Pllanej.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola